



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:168433
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05726182

C. nr.1538/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtare Edije Sezairi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.B. nga fshati Gornjasellë, komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë av.R.B. dhe av.L.B. që të dy nga Prizreni, kundër të paditurit I.B. nga fshati Gornjasellë, komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqësojnë av.S.H. dhe av.Xh.E. që të dy nga Prizreni, me objekt kontesti dorëzim i paluajtshmërisë, vlera e kontestit 3,100 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datë 02.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit I.B. nga fshati Gornjasellë, Komuna e Prizrenit.

II.DETYROHET i padituri I.B. nga fshati Gornjasellë, Komuna e Prizrenit që ti heq kubëzat e betonit nga sipërfaqja e parcelës kadastrale të paditësit numër 038-0 ZK Gornje Sellë, në pjesën e saj në formë të trekëndëshi, në pjesën verilindore të saj, me dimensione: në anën lindore në gjatësi prej 11,23m; në anën veriore në gjatësi prej 11,85 m dhe në anën juglindore në gjatësi prej 16,30 m, përkatësisht në sipërfaqe prej $S=66m^2$, ta lejë të lirë dhe të pastruar nga materiali ndërtimor dhe t'ia dorëzoj në posedim, përdorim dhe disponim të lirë paditësit Ibro Beqiri, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III.OBLGOHET i padituri I.B. që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajnë paditësit I.B. shumën prej 884.80 euro, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësi I.B. nga fshati Gornjasellë, komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë av.R.B. dhe av.L.B. ka paraqitur padi kundër të paditurit I.B. nga fshati Gornjasellë, komuna e Prizrenit, për shkak të dorëzimit i paluajtshmërisë.

Paditësi në padi ka theksuar se, ai është i pronar i vetëm i paluajtshmërisë në njësinë kadastrale P-71813012-00038-0 ZK Gornjasellë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 3023 m², me kulturë livadh. Kjo paluajtshmëri në anën perëndimore kufizohet me parcelën e të paditurit

nr.41-0 ZK Gornjasellë. Padiësi është me punë në botën e jashtme ku edhe jeton me familje, kështu që në vendlindje vjen gjatë pushimit. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia, padiësi për në kohë më të gjatë nuk ka ardhur në vendlindje. Duke e shfrytëzuar këtë situatë dhe mungesën e padiësit, me rastin e shtrimit me kubëza të betonit të një pjesë të parcelës së vetën nr.41-0, i padituri depërton në paluajtshmërinë e padiësit, në pjesën e parcelës kadastrale të tij nr.38-1, duke e shtruar me kubëza një pjesë në formë të trekëndëshit. I padituri pa kurrfarë baze ligjore e mbanë në posedim dhe shfrytëzim paluajtshmërinë, e njëherësh refuzon t'ia dorëzoj atë pjesë padiësit, në kuptim të nenit 93 të LPDTS, ka kërkuar nga gjykata që të merr aktgjykim dhe të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e padiësit, duke e detyruar të paditurin që t'i heq kubëzat e betonit nga sipërfaqja e parcelës kadastrale të padiësit nr.038-0, dhe këtë të lirë dhe të pastruar nga materiali ndërtimor t'ia dorëzoj në posedim, përdorim dhe disponim të lirë, padiësit si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

I autorizuari i padiësit gjatë shqyrtimeve përgatitore/kryesore ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë padisë. Pas administrimit të provave dhe fakteve të vërtetuara rrjedh se kërkesëpadia në tërësi është argumentuar dhe në tërësi është e bazuar në ligj. Mbi bazën e së drejtës së pronësisë kërkohet dorëzimi në posedim i paluajtshmërisë, pjesës së parcelës kadastrale nr.38-0 të përcaktuar me ekspertizë. Nga deklarata e të paditurit I.B. të dëgjuar si palë, është vërtetuar se parcelën nr.38-0 e ka blerë padiësi nga një person i nacionalitetit Serb, pasi është bërë ndarja e pasurisë ndërmjet babës dhe axhës së ndërgjyqësve dhe se sipërfaqen kontestuese e ka shtruar me kubëza të betonit i padituri në vitin 2015. Se nuk është i vërtet deklarimi i të paditurit kinse sipërfaqja kontestuese ka shërbyer si rrugë “me shekuj”, është vërtetuar nga ortofotot e nga aerofotografrit e viteve 2001, 2004, 2009, 2012 dhe 2018, të bashkangjitura raportit me shkrim dhe nga deklarimi i ekspertit vërtetohet se ndryshimet në pjesën kontestuese, kur kjo pjesë ka filluar të shfrytëzohet si rrugëkalim, kanë filluar nga ortofotot e vitit 2009, ndërsa shiriti gjelbërues vërtetohet tek në ortofotot e vitit 2018. Sa i përket deklarimeve të dëshmitarit të gjitha janë të pa vërteta dhe në kundërshtim me faktet e vërtetuara, aq më tepër në praninë e faktit se ky dëshmitar, që nga viti 1963 qysh para 60 viteve jeton në Prizren. I padituri pa kurrfarë baze ligjore e mban në posedim këtë parcelë, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovojë në tërësi kërkesëpadia e padiësit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë 104 €, taksa gjyqësore për padi 40 €, përfaqësimi në seancën e dt.11.10.2023, 135.20 €, për dt.17.11.2023, 200.00€, për dt.09.01.2023, 135.20€, për dt.26.02.2024, 175.60€, për dt.02.04.2024, 135.20 €, si dhe në emër të shpenzimeve të ekspertizës së gjeodezisë 200.00€, të gjitha këto në shumën e tërësishme prej 1,125.40 €.

Gjykata me aktvendimin C.nr.1538/21 të datës 26.07.2023, padinë së bashku me shkresat e tjera përcjellëse i'a ka dërguar padiësit duke e obliguar të njëjtin që në afat prej 15 ditësh të paraqes përgjigje në padi. Duke vepruar sipas aktvendimit në fjalë, i padituri përmes të autorizuarit të tij av.S.H. me datë 11.08.2023, ka paraqitur përgjigje në padi, përmes të cilës e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e padiësit. Ka theksuar se, nuk qëndrojnë pretendimet e padiësit pasiqë i padituri ato kubëza betoni i ka shtruar para 15 viteve, ku asnjëherë nuk ka pasur problem me padiësin dhe se në këtë drejtim i njëjti gjithmonë ka vepruar me mirëbesim duke respektuar të drejtat e personave të tjerë, fqinjëve e që në rastin konkret padiësi është vëllai i të paditurit dhe nuk ekziston ndonjë mundësi që i njëjti të veprojë në mënyrë të kundërligjshme përndryshe me siguri padiësi do të vepronte menjëherë e jo pas 15 viteve.

I autorizuari i të paditurit gjatë shqyrtimeve përgatitore/kryesore ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke kundërshtuar pretendimet e padiësit se kubëzat e

betonit janë shtruar gjatë kohës së pandemisë, sepse ato janë shtruar para 15 viteve dhe se në këtë drejtim asnjëherë nuk kanë pasur problem me paditësin. Paditësi dhe i padituri janë vëllezër dhe paluajtshmërinë e cila është objekt shqyrtimi ka qenë pjesë e përbashkët e trashëguar nga prindi, e cila pjesë është shfrytëzuar nga i padituri prej vitit 1950 e këndeje, e njëjta është shfrytëzuar edhe para paraardhësve të tij. Sa i përket ekspertizës siç dihet nuk është aq e saktë dhe precize, duke pasur parasysh se në regjionin ton incizimet e fundit satelitore janë të pa sakta sepse ka lëvizje e të cilat kanë shkaktuar pa kjarhtësi dhe telashe të mëdha në mes pronarëve me gjendjen faktike në teren, duke kërkuar nga gjykata që të mos ia fal besimin kësaj prove. Sipas deklaramit të dëshmitarit, në mes të ngastrës të cilën e shfrytëzon paditësi dhe i padituri ka qen një breg i cili ka ekzistuar çdo herë përmes të cilit breg ka ekzistuar edhe një rrugë nga kemi kaluar të gjithë familjarët. I padituri në deklaramin e tij ka shtuar se ngastrën kontestuese e shfrytëzojmë kah here me shekuj dhe se kjo gjendje nuk është nga dje por është nga e kaluara, andaj paditësi vetëm në bazë të inatit personal kërkon të më pengoj në këtë rrugë, ngase edhe aj e din se kjo rrugë nuk është e tij. Në fund i ka propozuar gjykatës që të refuzojë në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë, për përpilimin e përgjigjes në padi 104 € dhe 4 seanca të mbajtura me nga 135.20 €, gjithsej shumën prej 644.80 euro.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar këto prova: certifikatën me numër 07-029-4377-Ç-19 lëshuar me datën 29.08.2019 nga ZKK Prizren, ekspertizën e gjeodezisë të datës 01.12.2023, dëgjimin e dëshmitarit M.B. si dhe dëgjimin e të paditurit në cilësi të palës.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartë cekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga leximi i certifikatës me numër 07-029-4377-Ç-19, lëshuar me datën 29.08.2019 nga ZKK Prizren, gjykata ka vërtetuar faktin se ngastra kadastrale kontestuese me numër P-71813012-..... në sipërfaqe prej 3023m², evidentohet pronarë këtu paditësi I. (F) B.

Nga ekspertiza e gjeodezisë e datës 01.12.2023, e hartuar nga eksperti gjeodet L.a. si dhe nga skica e terrenit dhe fotot e shkrepura në teren, gjykata ka konstatuar faktin se kubezat e vendosura e që janë objekt kontesti, janë të vendosura në parcelën kadastrale nr.038-0, janë në sipërfaqe prej 60m², ndërsa sipërfaqja me gjelbërim, lisa dhe rrethoja druri 10m². Dimensionet e pjesës së parcelës nr.038-0 në shfrytëzim nga i padituri, në pjesën veriore nga pika nr.7 deri te pika nr.1 gjatësia është 11.68m, në pjesën lindore nga pika nr.1 deri te pika nr.2 gjatësia është 12.21m, në pjesën jug-perendimore nga pika nr.2 deri te pika nr.3 gjatësia është 2.72m, nga pika nr.3 deri te pika nr.4 gjatësia është 5.67m, nga pika nr.4 deri te pika nr.5 gjatësia është 5.59m, nga pika nr.5 deri te pika nr.6 gjatësia është 1.85m dhe nga pika nr.6 deri te pika nr.7 gjatësia është 1.06m.

I njëjti në seancën e shqyrtimit kryesor duke iu përgjigjur pyetjeve të palëve ndërgjyqëse ka deklaruar, në planet kadastrale për parcelën kontestuese nuk ka të evidentuar ndonjë objekt, gjithashtu edhe në orto foto të vitit 2001 dhe 2004 tereni ka qenë livadh dhe i pa ndryshuar tek në orto foto të vitit 2009, vërejmë që kanë filluar ndryshimet e gjendjes në teren

(hapje e një rruge) por që nuk mund të përcaktohet shiriti gjelbërues pasiqë nuk vërehet, i njëjti vërehet tek në orto fotot e vitit 2018.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitarit M.B. i cili para gjykatës ka deklaruar se paditësi dhe i padituri janë fëmijët e vëllait të tij F.B. se e din që kontestuese është pjesa parcelës, ka deklaruar se ka lindur dhe jetuar në këtë shtëpi cila edhe sot gjendet në parcelën ekzistuese. Parcela ekzistuese cila udhëhiqet në emër të I.B. në kadastrë është regjistruar në emër të I.B. mirëpo pjesa kontestuese në mes të parcelës së I. dhe parcelës ekzistuese të I. është breg-kodër e cila ka ekzistuar gjithmonë dhe përmes këtij bregu ka qenë rruga në të cilën kanë kaluar të gjithë anëtarët e shtëpisë. Në ndërkohë I.B. e ka ndërtuar objektin dhe e shfrytëzon këtë rrugë për të shkuar në objektin e tij, ka konsideruar se në tërësi Ibro nuk i pengon asgjë, kurse . ankohet dhe kërkon që pjesa e këtij bregu, respektivisht rruga ti takoj I. Ka konsideruar se nuk është në rregull që Ibro kërkon këtë. Në të vërtetë ekziston një problem i madh në mes tyre në kohën kur është bërë ndarja e theksuar, parcela i ka takuar të atit të tyre, e ata është dashur që mes vete ta zgjedhin këtë, nuk shoh se ka ndonjë pengese, konsideron se është vetëm çështje e marrëveshjes në mes tyre. Objekti me oborr i cili momentalisht i takon I. respektivisht të cilën shfrytëzon është ndërtuar para 15 vjete e ndoshta edhe më tepër. Kalimi – rruga në mes të këtyre dy parcelave ka ekzistuar që moti nga koha kur pasuria është udhëhequr në emër të atit tim, respektivisht gjyshi i palëve në procedurë. Ka shtuar se për të, të dy palët janë të njëjtë sipas gjinisë dhe në gjykatë kam ardhur ta tregoj gjendjen reale si ka qenë dhe si është tani. Ne jemi ndarë në vitin 1987 dhe kjo parcelë i ka takuar të atit të tyre. Unë kam tentuar që të iu gjej një zgjidhje jashtë gjykate në lidhje me këtë problem dhe kam biseduar me të dy se kjo çështje duhet të zgjidhet në mes tyre. Në pyetjen e të autorizuarit të paditësit, se kur është ndërtuar ky objekt ekzistues në parcelën e I.B. dëshmitari ka deklaruar se ka lindur në këtë parcelë, faktikisht në këtë kohë janë marrë me bagëti dhe e kanë shfrytëzuar këtë parcelë, objekti i I.B. në këtë parcelë është ndërtuar menjëherë pas luftës, respektivisht Ismeti këtë objekt ka ndërtuar pjesë -pjesë, së pari ka filluar me objekt më të vogël e pas kësaj është zgjeruar. I. e ka parcelën tij në afërsi të parcelës së I. por nuk kufizohen mes vete sepse ato i ndan bregu diku në lartësi prej 3metrave, nuk e din vijën kufizuese të parcelës së I. dhe I. sepse jeton në Prizren dhe atje shkoj ndonjë herë. Në Prizren jeton që nga viti 1963. Kjo është rrugë e vjetër për bagëti, shtegu të cilin kanë shfrytëzuar kur kanë pasur bagëti dhe kanë kaluar andej dhe kjo rrugë ekziston nga momenti kur janë marrë me bagëti, ky ka qenë shteg-rrugë të cilin e kanë shfrytëzuar derisa janë marrë me bagëti. Në vitin 1987 është bërë ndarja dhe gjatë kësaj ndarje babai i tyre ka marrë më së shumti, kurse më vonë ndarja në mes tyre si vëllezër për dëshmitarin nuk ka qenë qartë dhe nuk i ka interesuar sepse ka theksuar se jeton lartë. Ka shtuar gjithashtu se sa i përket parcelës që e mban I. nuk e din se a është pjesë e trashëgimisë së paraardhësve të tij dhe se kjo çështje nuk i intereson. Në vendin ku gjenden këto dy parcela në herën e fundit ka qenë para një muaji. Ndër tjera në pyetjet e të autorizuarit të paditësit, dëshmitari ka deklaruar se në vitin 1987 kur janë ndarë parcela kontestuese i ka takuar babait të tyre dhe më shumë nuk e di se si janë ndarë ata mes vete, se cila parcelë kujt i ka takuar, parcela i ka takuar babait të tyre F. Në të vërtetë ai nuk e di saktë se si janë ndarë ata. Nuk e di se parcela I. a ka qenë e F. nuk e di F. cilën parcelë ia ka dhënë I.e cilën I. Nuk i kujtohet se parcela e tanishme e I. a ka qenë objekt i ndarjes dhe në vitin 2004 nuk kam qenë në vendin ku gjendet parcela e I. dhe I. dhe nuk e di se sa është sipërfaqja kontestuese në mes të palëve.

I padituri I.B. gjatë dëgjimit të tij në cilësi të palës ka deklaruar se parcela e tij nr.41 zakonisht në fshat parcela e epërme e ka trapin e poshtëm, dallimi në lartësi nga parcela vëllait më duket se është 38, më së paku 3 metra, që logjikisht nuk mund të hyn në parcelën e tij, këtu ka një gabim kadastral, këtë parcelë e shfrytëzojnë me shekuj, babai i të paditurit, i padituri dhe se kjo gjendje nuk është nga dje, sipas konfigurimit të terrenit i njëjti nuk

përgjigjet assesi që të hyjë në këtë trekëndësh, e gjitha kjo e cila është paraqitur është bërë me qëllim që I. të ia mbyll rrugën dhe të ia pamundësoj punën. Në pyetjen e të autorizuarit të paditësit se kur janë vendosur kubëzat në sipërfaqen kontestuese, i padituri I.B. ka deklaruar se janë vendosur në vitin 2015 e ndoshta edhe më herët. Vija kufizuese në mes të parcelës sime dhe parcelës së I. në vendin ku gjendet sipërfaqja kontestuese, nga gjelbërimi edhe 3 metra nën gjendet kufiri i saktë, e jo ku tani momentalisht është gjelbërimi, faktin se trekëndëshi ku janë vendosur kubëzat dhe pojasi i gjelbërt në kadastër që udhëhiqen si pjesë të parcelës numër 38 pronë e paditësit, nga cila kohë e dini këtë fakt e din nga koha kur ka ardhur padia e deri në këtë kohë nuk ka pasur asgjë kontestuese. Rruga të cilën Ibro dëshiron të ia marrë në mënyrë që ta pengoj në biznesin e tij, e ndan gjysmën e epërm të oborrit nga gjysma e poshtme e oborrit, respektivisht është si prerje e oborrit dhe kjo rrugë ekziston me shekuj, ku edhe e kanë shfrytëzuar gjatë gjithë kohës, sepse aty kanë jetuar dhe jetojnë ende, ka shtuar se nuk e di saktë dhe nuk i intereson se kur e ka blerë Ibro parcelën numër 38, po e di se e ka blerë nga një serb pas ndarjes së pasurisë në mes të atit të të paditurit dhe xhaxhait.

Baza ligjore

Me nenin 7 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, është përcaktuar se, “Të drejtat sendore nuk parashkruhen, përveç ashtu si përcaktohet me ligj”, neni 18 par.1 i po të njëjtit ligj ka përcaktuar se, “*Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t’i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti*”, neni 36 par.1 ka përcaktuar se, “*Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri*”, ndërkaq neni 93 ka përcaktuar se, “*Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi*”.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Nga të gjitha faktet e administruara, pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe bazës ligjore të cekur më lartë, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet si e bazuar. Kjo për faktin se në certifikatën e pronësisë me numër 07-029-4377-Ç-19 e lëshuar më datë 29.08.2019 pronar i paluajtshmërisë P-71813012-..... me sipërfaqe prej 3023m² është këtu paditësi I.B. dhe atë si pronar i vetëm i saj. Kësaj prove gjykata i’a fali besimin e plotë. Siq u cek edhe më lartë, me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë gjendjes faktike, gjykata në këtë çështje ka angazhuar edhe ekspertin përkatës të gjeodezisë, i cili në raportin e tij me shkrim gjithashtu ka konstatuar se parcela kadastrale me numër 38-0 ZK Gornjosellë, e cila është e regjistruar në listën certifikatën nr 07-029-4377-Ç-19, në sipërfaqe prej 3023m², në të cilën është e përfshirë edhe pjesa kontestuese, evidentohet në emër të këtu paditësit me dimensione dhe shtrirje sikurse në ekspertizën e këtij eksperti. Po ashtu sipas ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë dimensionet e pjesës së parcelës që shfrytëzohen nga i padituri janë në sipërfaqe prej 60m², ndërsa sipërfaqja me gjelbërim, lisa dhe rrethoja druri 10m², në sipërfaqe të përgjithshme prej 70 m². Edhe kësaj ekspertize gjykata i’a fali besimin e plotë. Po ashtu edhe nga dekalrata e dëshmitarit M.B. gjykata e vërtetoi faktin se parcela ekzistuese cila udhëhiqet në emër të I.B. në kadastër është regjistruar në emër të I.B. dhe se rrugën me kublza e ka ndërtuar i padituri në ndërkohë.

Duke qenë se në bazë të së drejtës pozitive, paditësi I.B. është pronar i ngastrës kadastrale nr P-71813012-..... ZK Prizren dhe se i padituri është duke e mbajtur në zotrimin

Numri i lëndës: 2021:168433
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05726182

faktik këtë ngastër, gjykata vlerëson se në këtë rast, paditësi si pronar ka të drejtën që të kërkojë nga mbajtësi, në këtë rast këtu i padituri, kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale, e që në këtë rast është ngastra kadastrale nr P-71813012-..... ZK Prizren, respektivisht pjesa e saj me dimensione dhe shtrirje sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Andaj gjykata ka ardhë në përfundim se padia e paditësit duhet të aprovet në tërësi si e bazuar.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452 par.1 të LPK-së, dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.00 €, në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 40.00 €, për përfaqësim në seanca gjyqësore gjithsej 4 seanca gjyqësore të mbajtura nga 135.20 euro, gjithsej 540.80 euro, si dhe në emër të pagesës për shpenzimet e ekspertimit shumë prej 200.00 euro, të gjitha këto në shumë e përgjithshme 884.80 euro.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si n dispozitiv të këtij aktgjykimi, e duke u bazuar në nenin 143.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI CIVIL
C.nr.1538/2021 datë 02.04.2024

G j y q t a r e
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa brenda afatit 15 ditor pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.